

VENDIM
Nr.716, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “ERDAT” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “LURA 1”,
“LURA 2”, “LURA 3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Erdat” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Lura 1”, “Lura 2” e “Lura 3”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha